



Kuvendi i Komunës Klinë  
Komiteti për Politikë dhe Financa  
01Nr 06-41688 /22  
Klinë, dt: 12.12. /22

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IX-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 14.11.2022, me fillim nga ora 9:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSB-në, drejtorët, zyrtarën për komunitete dhe të pranishmit të cilët ishin pjesëmarrës në mbledhje të KPF-së.

Më pas, Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i kërkesës për shpallje zonë me interes publik pronat private për rregullimin e liqenit akumulues dhe rregullimin e shtratit të Lumit “Drini i Bardhë” (ref. nga DUMM),
4. Shqyrtimi i kërkesës për ndarjen e parcelës nr.P-71006024-00422-0 për ndërtimin e çerdhes ( ref. nga DKA),
5. Shqyrtimi i kërkesës për shpallje zonë me interes publik pronat private për ndërtimin e rrugës në zonën e Dresnikut ( ref. Nga DUMM),
6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin shtator-tetor 2022,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi debat rreth rendit të ditës!

**Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 7 vota PËR, u miratua rendi i ditës.**

**Pika 1. Arsyetimi i mungesave.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Të gjithë anëtarët e Komitetit janë prezent.

**Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga seanca e kaluar?

**Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.**

**Pika 3. Shqyrtimi i kërkesës për shpallje zonë me interes publik pronat private për rregullimin e liqenit akumulues dhe rregullimin e shtratit të Lumit “Drini i Bardhë” (ref.nga DUMM).**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Po, urdhëro drejtor, z. Enver Berisha?

**Enver Berisha, drejtor i DUMM:** Përshëndetje kryesues, përshëndetje anëtarë të nderuar! Ne kemi pasur nevojë që ta vëmë në rend të ditës shpronësimin e atyre pronave realisht me arsyetimin se edhe në auditim kemi shumë vërejte se po investojmë në prona private. Ne e dimë se lumi ka devijuar dhe është në prona private, duhet medoemos me e bërë një formë të shpronësimit, me kusht që ne të veprojmë me projekte se, tash ne e kemi matur, realisht shënimet që janë marr, janë duke u marr të 2018-tës të lumit por ne e kemi edhe në hartë zonale, lumi është në formë ekzistuese që ka sot. Nuk është saktësisht gjithçka, unë kam marr shënime prej kadastrës, nuk do me thënë që është fikse me centimetër sepse gjatë kontrollave tjera mund të ketë ndryshime ose gjatë negociatave mund të ketë ndonjë lëvizje. Por edhe me rrugën “ Malë Bashota”, ne, në ekzekutim e sipër patëm telashe me pronarin, atëherë është dashtë me kusht me jua drejtuar juve që të shpallet zonë me interes pastaj të vazhdojmë me punime sepse është edhe rekomandim i auditorit, edhe kemi telashe se mund të pasojmë me pasoja juridike gjatë ekzekutimit të këtyre punimeve. Shënimet janë të dhëna nga gjeodeti, aty ku ka ndonjë paqartësi ndoshta me siguri mund të ju ndihmojmë, do të vazhdojnë prapë me u bë matjet, nuk do me thënë që është fikse sepse mund të ndodh që gjatë negociatave pronarë në komunë nuk bijnë dakord edhe ne mundemi me lëviz, mirëpo mund të lëvizim deri në ato suaza sa është e lejueshme. Unë kam informacion prej kadastrës se ekzistojnë disa dokumente të shpronësimit, që mund të ndodhë ajo listë e cila është e shënuar, mund të ketë ndonjë plotësim-ndryshim, pra, ajo



mund të ketë ndryshim-plotësimin në kohën që kur të fillojnë takimet, kur të fillojnë negociatat, por mos ta marrim fikse që mund të ndodh që ajo ka vendim shpronësimi ajo pronë, ajo pjesë hiqet prej liste. Faleminderit!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Është mirë deri sa të shkojmë në seancë, regjistri me qenë final, se kur të merret vendimi, më as pikë as presje vendimit nuk i hiqet, si ta ngremë dorën anëtarët e Kuvendit më nuk ka ndryshime, veç duhet me thirr një seancë tjetër për me bë ndryshime. Te negociatat është Ligji për dhënie në shfrytëzim të pronave publike, aty ka negociata, është procedurë tjetër, kryetari e fillon negociatën por në këtë si e keni kërkuar me shpallje në interes të përgjithshëm edhe për shpronësim këtu negociatë nuk ka, palët mund të na dërgojnë në gjykatë po negocim me ta nuk ka. Për këtë, deri në seancë është mirë edhe Zyra ligjore me pas një interpretim, se ne kur ta marrim vendimin në seancë s'ka më mbrapa, veç me një seancë tjetër mund ta ndryshojmë. Urdhëro, Tunë!

**Tunë Dedaj:** Unë e kuptoj që negociata duhet të ketë përpara shpronësimit me qytetarë nëse është në pyetje ndërrimi i tokës, ajo mundet me pas negociatë para se ne me hy në shpronësim, por kur hyjmë në shpronësim, atëherë ti nuk duhet ta pyesësh askënd, se po t'i pyesësh, ata kurrë s'ta japin, ky është mendimi im!

**Enver Berisha, drejtor i DUMM :** Me sa di unë kjo, mos po dalim në hapin e dytë ne, se hapi i parë është shpallje në zonë me interes se shpronësimi është hapi i dytë, tash mos i kemi përzier pak gjërat që ne jemi te shpall zonë me interes, ne nuk jemi duke e shpronësuar, edhe pastaj kur shpallet zonë me interes atëherë hyjnë analizat e thella që kah, qysh e tek.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Po, por ne po e miratojmë listën, cilat zona po shpallen në interes ju tjetër zonë nuk mund ta bëni, për këtë është telashe ky regjistri që e kemi pranuar ne, nëse tash ne me këtë regjistër dhe i shpallim zonë me interes publik, megjithëse këtu po del se qenkan të 2017-tës me shumë pronarë.

**Enver Berisha, drejtor i DUMM:** Ajo është një shënim, kryetar, një shënim i matjeve gjeodezike në terren, e cila është matur në lumin ekzistues që është sot, dmth shtrati i lumit që është sot, se ne e dimë se ka devijuar shtrati, nuk është në pjesë kadastrale që e ka lumi, edhe problemi është që në atë listë që e kemi nuk është lumi në atë pjesë, ajo listë që është me emra me parcela qaty ka me u rregullu. Tash mund të ndodh që deri në mbledhjen e ardhshme, pastaj të shtohet ndonjë vendim që ka dikush, dikush thotë një parcelë e ka vendimin, dikush thotë se nuk e ka, mirë është me ju shtu asaj ose kërkojmë prej Zyrës së pronës juridike që t'na sigurojë çdo dokument që procedon komuna që mos të shpronësohet dy herë.

**Tunë Dedaj:** E di këtë problematik se familjes sime të gjerë, jo mua personalisht, i kanë marr tokë edhe shtratin e lumit e kanë lënë, nuk e kanë qu, do të thotë ti ke hyrë ja ke marr pa e shpronësuar edhe kjo është që ti nuk mundesh tash, ti e ke marr, e ke bart te ai, e ka kry ai, dmth ajo është e kryer, ti vetëm nëse do me kthy përsëdyti, edhe familjarët unë e di që kërkojnë me ju bërë zëvendësimi i tokës jo me ju shpronësuar por me ju bë, edhe ata më përpara ta shpronësojnë sesa i marrin lekët, kështu që ka aty mundësi me u rregullu po unë e di është mirë me u nxjerrë lista me u ditë, me ju qu pronarëve me emër, mbiemër, ata me ditë çka ne sjellim vendim këtu, jo përmendësh, se nëse e bëjmë një punë përmendësh nuk është në rregull, se ndoshta ata pajtohen



pa e shpronësuar me ndrru e për me ndrru nuk ka nevojë me hy Kuvendi, kështu e di unë.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit, Tunë! Ligji e obligon ekzekutivin kur të fillon procedura e shpronësimit me i njoftuar palët, me i dërguar shkresë palëve, që kjo parcelë është në procedurë të shpronësimit, e interesin publik të këtyre parcelave kush nuk është duke i kontestuar sepse është interes i përgjithshëm, këtu nuk e kemi më asi dileme, veç te procedurat edhe te ngastrat se ne, nesër shkojmë në seancë edhe i shpallim zona të interesit, e na dalin ngastra që tash që po thotë drejtori që u shpronësua njëherë, ne ende nuk e kemi një pasqyrë as shërbimi pronësor juridik nuk e ka sjellë, po deri në seancë besoj që ka kohë me i plotësu edhe ato. Urdhëro Tunë!

**Tunë Dedaj:** Nëse është shpronësuar, toka nuk është në emra të qytetarëve, nëse nuk është bërë shpronësimi, atëherë toka është në emër të qytetarëve. Ti qytetarit nuk mund t'ia marrësh tokën nëse ka ekzistuar ndonjëherë gjatë 50 viteve në shpronësim që është ende në emër të qytetarëve toka, ti je duke ja marr tokën, je duke e konfiskuar se ai s'ka marr lekë, as s'ka marr asgjë, ata ndoshta kanë bërë vendime koti, sikur ne me bërë sot një vendim këtu edhe mos me jua dhanë paratë kurrë atyre, për të kaluarën e kam fjalën.

**Enver Berisha, drejtori i DUMM:** Mua më është dashtë të hulumtoj rreth këtij problemi edhe të shoh a ekziston forma që po thua ti, në fakt ekziston pronë e shpronësuar, mjetet i kanë marr e toka e cila është në emër të pronarit, ajo është ku është liqeni akumulues, por në fakt ekziston në emër të pronarit, sepse nuk është kryer procedura e ndërrimit të pronarit përmes Zyrës së pronës juridike. Po këtu më mirë është të ftohet Zyra ligjore dhe të diskutohet me zyrën ligjore se unë kam veç inicim i nderuar, edhe shërbimi gjeodet, unë veç inicioj format, mënyrën se si kalon, si shkon, nuk po më intereson mua ajo. Faleminderit!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Kërkesa na ka ardhur nga Drejtoria e Urbanizmit, krejt materiali tjetër është i Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit, pjesa tjetër i takon shërbimeve tjera, edhe Zyra ligjore mund të na ndihmojë. Rrjedha e Drinit e ka bërë të veten, ka lëviz prej shtratit, këto asnjë nuk janë kontestuese veç nëse dikush është shpronësuar më herët, e ka mbetur për shkak të procedurës por mund të vërtetohet me çfarëdo dokumenti që ai njëherë është kompensuar. Kjo është me dëshmi e mjaftueshme që ti e ke kryer kompensimin, ti e fillon procedurën e shpronësimit, nëse dëshmohet se ajo ka bërë një kompensim, nëse nuk dëshmohet kjo, jemi të gjithë viktimë e saj tani, a ka dikush tjetër? Urdhëro, Silvija?

**Silvija Rashkoviç:** Kam nevojë të pyes, nëse pronarët e pronave përgjatë lumit do të kompensohen me mjete financiare apo do të bëjnë ndërrim tokën me dikë tjetër? Sepse ka shumë pronarë që janë të komunitetit serb dhe si përfaqësuese e zyrës për komunitete më intereson ta di këtë informatë.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Unë e sqarova edhe më herët, ne jemi duke folur që t'i shpallim zona të interesit të përgjithshëm për momentin, hapi i parë është ky, i dyti fillon shpronësimi. Ajo pastaj duhet të kompensohet, mënyra e kompensimit sipas Ligjit për shpronësimin është njësi e veçantë në kuadër të Ministrisë së Financave, që del në terren edhe e bën vlerësimin e pronës.

**Silvija Rashkoviç:** Mua më intereson të di se, pronarët e atyre pronave ku do të dëmtohen?



**Fadil Gashi, Kryesues:** Pronarët veç janë të dëmtuar, por ne jemi të obliguar ta kompensojmë dëmin, për atë bëhet kompensimi. Atëherë ne me këto kërkesa që kërkohet nga zyra ligjore, nga kadastra dhe nga shërbimet pronësore juridike, deri në seancë le ta plotësojnë edhe me material dhe në seancë le të vijnë të tria, për t'i dhënë sqarimet e nevojshme në dilemat që mund t'i kenë anëtarët e Kuvendit. A ka dikush tjetër, nëse s'ka, kush është për rekomandim?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, por që deri në seancë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi dhe Zyrën Ligjore, të përgatisin një elaborat të detajuar sa i përket kësaj çështje.**

**Pika 4. Shqyrtimi i kërkesës për ndarjen e parcelës nr.P-71006024-00422-0 për ndërtimin e çerdhes ( ref. nga DKA).**

**Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së:** Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë! Po besoj se çerdhja “Gjevë Lladrovci” është shumë e ngarkuar, duke e parë që ka shumë fluks dhe kërkesa të mëdha, kjo ka qenë e paraparë në Malizhgan të bëhet me harta zonale, por aty është anuluar vendimi sepse kryeministri i ka ndaluar ato prona. Atëherë e kemi parë si shumë të nevojshme të ndajmë një parcelë prej 30 ari në shkollën “Motrat Qiriazhi”. Kisha kërkuar nga ju pasi që është në interes të gjithë qytetarëve të Klinës që të kalojë një kërkesë e tillë. Faleminderit!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit drejtor, meqë jemi te çerdhja, a ka dikush? Po urdhëro, Tunë?

**Tunë Dedaj:** Po, drejtor, faleminderit, por së pari unë nuk e di ku kanë ngecur punimet që janë në Deiq, që qysh se ka qenë PDK-ja në pushtet ka filluar ndërtimi dhe ende kurrë s'i erdhi përfundimi! Por është mirë këtu të na informoni edhe unë jam që t'i ndahet edhe të merret ajo parcelë dhe të bëhet çerdhja tjetër, por në radhë të parë do të ishte mirë kjo të përfundojë edhe në shtator të ja fillojnë fëmijët aty të shkojnë në çerdhe, se kjo që është ekzistuesja, me thënë të drejtën kjo s'i plotëson kushtet as për së afërmi, se numri i fëmijëve që mund t'i marrin është shumë i limituar.

**Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së:** Me shqetësimin që e adresoj Tuna, dmth unë jam i njoftuar. Kam marr disa veprime por ju kam drejtuar ministres dhe sekretares së MASHTI-it me disa imella të bashkëngjitura me foto të çerdhes në gjendjen që ka qenë, tani dmth që katër ditë kanë filluar të intervenojnë në pjesë të saj, sa kam marr informacion unë, që kompania që ka pasur ta ndërtojë një projekt tre vjeçar, ka dështuar dhe tash e kemi një të mirë që kanë filluar të punojë me atë pjesë. Por duke paraparë që dmth çerdhja është në vende rurale, ajo pjesë nuk është në pjesë të qytetit, ne e kemi shumë të nevojshme edhe një çerdhe me e hap në një pjesë të qytetit, kaq, faleminderit!

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit, po urdhëro, Valmire?



**Valmire Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë, ky projekt për ndërtimin e çerdheve është shumë me vend se qytetit tonë i duhen çerdhe sa më shumë, por vendi ku e kanë ndarë nuk po më duket edhe shumë e arsyeshme, për arsye se atje është edhe një çerdhe private. Pse nuk ndërtohet p.sh., te lagjja “Arbëria”, kam njohuri për një parcelë publike që mund të shfrytëzohet për ndërtimin e kësaj çerdhe.

**Qemajl Sejdiqja, drejtor i DKA-së:** Po besoj që ne kemi kërkuar parcela të ndryshme nëpër qytetin e Klinës sa i përket pjesës shtetërore, se ne e dimë nuk mund ta ndërtojmë edhe për ta ndërtuar një çerdhe na duhen 30 ari, dmth ne e kemi pasur të pamundur për ta siguruar një pjesë tjetër, jo me dëshirën tonë, por nuk kemi pasur hapësira tjera dhe atëherë jemi detyruar ta dërgojmë aty poshtë kërkesën tash.

**Valmire Krasniqi:** Unë nuk kam njohuri sa ari është ajo pjesë, veçse e di që është pronë publike. Aty jo që duhet një çerdhe por edhe një shkollë, për arsye se në shkollën “ Ismet Raci “ ata që vijnë janë të lagjes “Arbëria”, Dresniku dhe Dolci, një klasë ka 42 nxënës, paramendoje çfarë mësimi mund të zhvillohet aty, ku një klasë është me 42 nxënës, jo një çerdhe por në atë pjesën andej nevojitet edhe një shkollë që të ndërtohet .

**Fadil Gashi, Kryesues:** Faleminderit, Valmire, a ka edhe dikush tjetër?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së DKA-së, për ndarje të një pjese prej 3 000 m<sup>2</sup> për ndërtimin e çerdhes nga parcela nr.P-71006024-00422-0, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 5. Shqyrtimi i kërkesës për shpallje zonë me interes publik pronat private për ndërtimin e rrugës në zonën e Dresnikut ( ref. Nga DUMM).**

**Fadil Gashi, Kryesues:** Është e njëjta me këta që e kaluam më herët, edhe kjo është shpallje zone me interes publik, kjo veç e ndërron destinimin, është për ndërtim të rrugës. Nuk po ua kufizoj të drejtën juve, por është natyrë e njëjtë, nuk dallon asnjë gjë, veç synimi që është për rrugë këndeje. A ka dikush, a mundemi ne krejt atë që e thamë për të parën, të vlejë edhe për këtë të dytën?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, por që deri në seancë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi dhe Zyrën Ligjore, të përgatisin një elaborat të detajuar sa i përket kësaj çështje, ashtu siç është kërkuar në rastin e kërkesës për shpallje “Zonë me Interes Publik” pjesët e ngastrave për rregullimin e shtratit të Lumit “Drini i Bardhë” dhe Liqenin Akumulues.**



## **Pika 6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin shtator-tetor 2022.**

### **Kërkesa 1.**

Kërkesë për ndihmë financiare, e parashtruar nga znj. Ibadete Avdyli, e cila thekson se është në një gjendje të rënduar shëndetësore si rezultat i diagnostikimit me CA-kancer si dhe duke marrë për bazë gjendjen e rënduar ekonomike, pasi që jeton me një pension të veteranit nga burri. Shpenzimet të cilat krijohen për trajtimin e sëmundjes arrin vlerën prej 2500 euro në muaj, gjë që është e pa përballueshme për ekonominë familjare, andaj kërkon mbështetje financiare.

**Fadil Gashi, Kryesues:** A ka dikush diçka?

**Tunë Dedaj:** Është mirë edhe këtë kërkesë ta dërgojmë si kërkesat tjera, në Zyrën e kryetarit, aq sa ka mundësi të ndajë, është mirë t'i ndihmojmë. Po më bie ta përsëris shpesh se, kur një qeveri nuk bën sigurime shëndetësore pastaj ne po obligohemi nga buxheti i qytetarëve të ndajmë mjete për këta nevojtarë.

**Fadil Gashi, Kryesues:** Unë e di se sipas strukturës ligjore duke i përfshirë edhe gjitha aktet tjera nënligjore që e mbulojnë këtë fushë, sidomos nga ministria, ata e kanë obligim të ua mbulojnë këto fatura, gjitha shpenzimet që bëhen, një pjesë të tyre. Por kjo nuk do të thotë që ne mos të ju gjendemi edhe sikur rasteve tjera, është mirë për aq sa ka mundësi po ndoshta është mirë që nëse jo në këtë takim, në takime tjera me e pas edhe një raport kthyes me parë, se ne bukur do rekomandime po i bëjmë po s'po dimë a po përfitojnë, a ka pengesa, nëse janë pengesa teknike për shkak të mundësive buxhetore nganjëherë ose prej zyrës së thesarit ose zotime t'mjeteve, këto janë normale por mos me mbet pa u trajtuar kështu si raste, a ka dikush tjetër?

**-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. I.A. për ndihmë financiare, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në zyrën e kryetarit dhe t'i ndihmohet sipas mundësive buxhetore.**

### **Kërkesa 2.**

Kërkesë e parashtruar nga drejtori i SHFMU "Ymer Berisha" Siqevë, për ndërrimin e kaldasë në shkollës, pasi që kaldaja e tanishme është 250KW ndërsa për ngrohjen e hapësirës nevojitet 400KW pasi që shkolla ka 1400 m<sup>2</sup> andaj për funksionim më të mirë të ngrohjes nevojitet ndërrimi.

**Tunë Dedaj:** Unë s'kisha për tu pajtuar kurrë që një kërkesë të tillë ta shqyrtojmë ne këtu, se kjo është dashtë të ju drejtohet Drejtorisë së Arsimit dhe kjo Drejtori të bëjë krejt çka është më mirë për atë shkollë, për ata nxënës.

**Qemajl Sejdiya, drejtor i DKA-së:** Ne e kemi pasur një shkresë të tillë nga shkolla edhe për kaldajën e cila është vjetruar, kemi intervenuar në kalda dhe tash është rregulluar. Për shkak të mungesës së mjeteve për këtë vit deri në vitin tjetër, Drejtoria e Arsimit i ka paraparë që t'i ndryshojë kaldajat, dmth me filluar me pompa termike për mos me pas probleme, se kemi shumë probleme të kaldaja që janë mbuluar, për atë edhe kemi pasur përgjigje, dmth ju kemi përgjigjur edhe drejtorit edhe kompania e ka sanuar problemin dhe kaldaja është në rregull, ju falënderoj!

**Tunë Dedaj:** Mua po më vjen shumë mirë që e dëgjova drejtorin se ka nevojë që shumë shpejtë, çdo shkollë të ketë pompa termike, ajo është zgjidhja e vetme për ta mbrojtur buxhetin e komunës së Klinës, shpenzimet janë shumë të vogla dhe nxehja është shumë e mirë.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Isni Rraci, drejtor i shkollës në SHFMU "Ymer Berisha" Siqevë, me 7 vota PËR, rekomandoi që DKA-ja të vazhdojë me projektin e ndërrimit të kaldajave në shkolla, duke i zëvendësuar ato me pompa termike.**

**Pika 7. Të ndryshme.**

**Fadil Gashi, Kryesues:** A ka dikush? Nëse s'ka, unë sinqerisht po ju falënderoj për pjesëmarrje dhe për angazhim, shihemi në takimin e radhës!

**Procesmbajtësja,  
Monika PALUSHI**

*MPalushi*



**KRYESUESI,  
Fadil GASHI**

*Fadil Gashi*